

Axhenda

22GJ106 - Promovimi i rëndësisë të shëndetit mendor te nxënësit e moshës 6-16 vjeç.

1. Lloji i trajnimit

Trajnim i drejtpërdrejt (Neni 5/1 i Udhëzimit)	V
Trajnimi nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime (Neni 5/2)	V
Trajnimi nëpërmjet internetit (Neni 5/3)	V

2. **Titulli i programit të trajnimit:** Rritja e njohurive dhe aftësive të mësuesve për të promovuar sjellje të shëndetshme te nxënësit e moshës 6-16 vjeç.

3. **Tema e modulit:** Shëndeti mendor te nxënësit e moshës 6-16 vjeç

4. **Numri i orëve të modulit të trajnimit:** 18 orë (9 orë trajnim i drejtpërdrejtë ose online dhe 9 orë punë individuale).

5. **Numri i krediteve:** 1 kredit

6. **Numri i seancave dhe tema e çdo seance:**

Seanca të drejtpërdrejta ose online (9 orë gjithsesj)	Tema
Seanca 1 (1.5 orë)	Shëndeti mendor dhe stresi kronik
Seanca 2 (1.5 orë)	Shkaqet dhe simptomat e lidhura me stresin
Seanca 3 (1.5 orë)	Stresi tek adoleshentët
Seanca 4 (1.5 orë)	Bullizmi te fëmijët e shkollave
Seanca 5 (1.5 orë)	Format e shfaqjes së bullizmit

7. Përfituesit nga trajnimi:

- Mësuesit e Arsimit Fillor.
- Mësuesit e Arsimit të Mesëm të Ulët të lëndëve të Biologjisë, Edukimit Fizik dhe Qytetarisë.
- Mjekë, psikologë dhe punonjës socialë të institucionit arsimor.
- Drejtor i institucionit arsimor të arsimit bazë.
- Specialistë të DRAP/ZVAP-ve.

8. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të trajnimit pritet që pjesëmarrësit të:

- përshkruajnë shkaqet e stresit te adoleshentët.
- shpjegojnë simptomat emocionale dhe fizike që lidhen me stresin.
- analizojnë rëndësinë e menaxhimit të stresit te adoleshentët.
- gjykojnë mbi efektet negative të bullizmit te fëmijët.
- vlerësojnë format e ndryshme të shfaqjes së bullizmit.